



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2018:031650

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05785950

P.nr.17/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me procesmbajtësen Hale Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurit S.H, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.178/16 të datës 24.01.2018, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike të shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë më datë **16.04.2024**, në praninë e Prokurorit të Shtetit Sadije Muriqi, të pandehurit S.H dhe mbrojtësit të tij av. Gëzim Kollqaku, të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 14.05.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

S.H, i lindur me datë ... ne fshatin O. ku edhe banon Komuna I., nga i ati S. dhe e ëma H. e gjinisë I., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes se mesme ekonomike, i identifikuar ne bazë të letërnjoftimit me numër ..., shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Në kohë të pacaktuar e deri me datë 13.06.2016 në ora 19:50 në fshatin Orroberdë Komuna Istog, pa autorizim posedon armë dhe atë një pistoletë me nr. 21987, kal.9 mm Crvena Zastava, prodhim jugosllav, tetë fishekë kal.9mm, në atë mënyrë qe i pandehuri Sami gjersa ishte afër restaurantit “Viena” në vendin e sipërshënuar për një moment e nxjerr armën në fjalë dhe më pas nga policia e Kosovës gjatë kontrollit i është gjetur arma e sipërshënuar e cila edhe është sekuestruar.

- me këtë ka kryer veprën penale **mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.**

Gjykata duke u bazuar në nenin e lartcekur të veprës penale dhe dispozitat e nenit 2, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70 të KPRK-së dhe neneve 230, 364, 369 të Kodit të Procedurës Penale (tutje KPP-së), të pandehurit i shqiptohet:

DËNIM MË GJOBË

- I. Ashtu që, të pandehurit **S.H.**, i shqiptohet **dënim me gjobë në shumën prej katërqind (400) euro**, të cilën gjobë obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
 - Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguan dënimin me gjobë në afatin kohor të përcaktuar me lartë, atëherë dënimi më gjobë do të zëvendësohet më dënim me burgim, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, ku njëzet (20) euro të gjobës, do të llogariten me një (1) ditë burgim, *përkatësisht 20 ditë burgim.*
- II. **URDHEROHET** konfiskimi i armës e llojit pistoletë, model Zavodi Crvena Zastava, Kragujevac- Jugosllavija, me nr.21987, kal.9 mm, një karikator i saj dhe tetë fishekë kal.9 mm. Te cilat kanë qenë të sekuestruar në këtë çështje penale nga Stacioni Policor në Istog, numri i rastit 2016-DF-384. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të njëjtat duhet të shkatërrohen nga Policia e Kosovës.
- III. **OBLIGOHET** i pandehuri që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **njëzet (20) euro**, ndërsa në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej **njëzet (20) euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV. Palë të dëmtuar nuk kishte.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.178/16 të datës 24.01.2018, kundër të pandehurit S.H për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, të cilës aktakuzë i është bashkangjitur edhe marrëveshja për pranimin e fajësisë me numër PP/II.nr.178/16 e datës 15.01.2018, e arritur ndërmjet Kryeprokurorit dhe prokurorit të shtetit të kësaj prokurorie, në njërën anë dhe të pandehurit S.M dhe mbrojtësit të tij av. Selim Lajqi, në anën tjetër.

Gjykata me datë 27.09.2023, ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore lidhur me shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Sadije Muriqi, i pandehuri S.H se bashku me mbrojtësin e tij av. Gëzim Kollqaku i caktuar sipas

autorizimit, në të cilën seancë është shqyrtuar marrëveshja mbi pranimin e fajësisë, me ç'rast pas dëgjimit të palëve, lidhur me marrëveshjen për pranim të fajësisë, është konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe marrëveshja është bërë në baza vullnetare pas konsultimeve të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, i pandehuri nuk ka qenë i shtrënguar apo i detyruar në lidhjen e marrëveshjes, pranimi i fajësisë mbështet në faktet dhe provat që i janë bashkëngjitur aktakuzës, si dhe nuk ekziston asnjëra nga rrethanat për hudhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale të përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPP-së, andaj gjykata ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ka mbështetje ligjore dhe është e bazuar në nenin 230 par. 20 të KPP-së dhe si të tillë e ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë.

Gjykata pas pranimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, te njëjtën ditë ka vazhduar seancën për caktimin e dënimit, ku:

Prokurori i shtetit ka deklaruar se sipas marrëveshjes së arritur janë dakorduar edhe për dënimin, ashtu që i ka propozuar gjykatës që dënimi për të pandehurin të jetë dënim me gjobë në shumën prej katërqind (400) euro, dhe të konfiskohet arma e llojit pistoletë e kal.9 mm, prodhim “Crvena Zastava” me nr. Ser. 21987.

Mbrojtësi i të pandehurit S.H, av. Gëzim Kollçaku, ka deklaruar se qëndroj pranë propozimit për dënimin të përcaktuar në marrëveshjen për pranimin e fajësisë me numër PP-I.nr.178/16 e datës 15.01.2018, e cila gjendet në shkresat e lëndës.

I pandehuri S.H ka deklaruar së pajtohet me dënimet e përcaktuara në marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe përkrah deklarimet e mbrojtësit të tij.

Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri S.H, në kohën dhe vendin kritik, ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësisë dhe rrethanat personale se është penduar për veprën penale të cilën e ka kryer. Ndërsa **rrethana rënduese** ka gjetur se ka qene i dënuar edhe me parë me aktgjykime të formës së prerë në çështjen penale të evidentuara me numër të SMIL-it: 2018:042457 . Prandaj, në rastin konkret nga rrethanat e lartcekura, gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit si në dispozitiv të aktgjykimit, i cili dënim ka qenë i përcaktuar edhe në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e këtu të pandehurit, i cili do ta kuptoj rëndësinë e veprës penale të cilën e ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektoj që në të ardhmen mos të shkaktoj veprime të ndaluara- përkatësisht

mos të kryej vepër penale, si dhe do të ndikoj tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për konfiskim

Gjykata konform nenit 367 par.3 të KPRK-së, vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke urdhëruar konfiskimin e armës dhe sendeve tjera aksesore të precizuara si më lart, të cilat i pandehuri i ka poseduar në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët.

Shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 dhe nenit 452 par. 1 të KPP-së, e ngarkoi të akuzuarin me shpenzimet e procedurës, të precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e po ashtu konform të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, e obligoi të paguaj shumën prej 20 euro në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara e në bazë të neneve 230, 364 dhe 369 të KPP-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

Procesmbajtësja
Hale Ahmetaj

GJYQTARI
Petrit Nrecaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovë në Prishtinë, *në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.*